



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 63

30 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 295, datë 20.3.2013	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore..... 2767
Vendim i KM nr. 296, datë 3.4.2013	Për miratimin e rregullit teknik “Për informacionin e tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”..... 2770
Vendim i KM nr. 297, datë 10.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 17, datë 21.1.2000 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin dhe kontrollin e fondeve publike për veprimtari specifike, operative, të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar..... 2789
Vendim i KM nr. 298, datë 10.4.2013	Për emërimin në detyrë të anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 2790
Vendim i KM nr. 299, datë 10.4.2013	Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr. 74, datë 1.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për vijimin e procedurave të privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”..... 2790
Vendim i KM nr. 300, datë 10.4.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Merko” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..... 2791
Vendim i KM nr. 303, datë 10.4.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Gentian Demaliaj..... 2791
Vendim i KM nr. 305, datë 10.4.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajftshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Muhurr të qarkut të Dibrës..... 2792

Vendim i KM nr. 306, datë 10.4.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rrape të qarkut të Shkodrës.....	2793
Vendim i KM nr. 308, datë 10.4.2013	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar.....	2794
Vendim i KM nr. 359, datë 24.4.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar.....	2794
Udhëzim i MASH & MF nr. 7, datë 8.3.2013	Për një ndryshim dhe shtesë në udhëzimin nr. 29/1, datë 16.08.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”.....	2795
Udhëzim i MMPAU nr. 4 datë 15.4.2013	Për dokumentacionin e aplikimit për leje mjedisi të tipit A, B dhe C në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL).....	2796
Udhëzim i MMPAU nr. 4, datë 22.4.2013	Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullësor publik.....	2804
Vendim i BSH nr. 26, datë 27.3.2013	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.....	2809
Vendim i BSH nr. 27, datë 27.3.2013	Për disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”.....	2813
Vendim i BSH nr. 28, datë 27.3.2013	Për disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.....	2814
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Astrit Danushi.....	2814
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Hakik Mena.....	2815
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të shtetasit Dritan Brahimë.....	2815

VENDIM
Nr. 295, datë 20.3.2013

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT
SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 pika 3, 51 e 56 të ligjit nr. 10 433 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 6 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar, të nenit 40 të ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe të nenit 26 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

1. Krijohet Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (këtej e tutje në tekstin e këtij vendimi “ISHPSHSH”), si institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për punën dhe çështjet sociale.

II. MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHPSHSH-së

2. ISHPSHSH-ja ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atij të shërbimeve shoqërore.

3. ISHPSHSH-ja është përgjegjës për inspektimin e zbatimit të kërkesave ligjore:

a) të punës sipas legjislacionit të punës;

b) në fushën e shërbimeve shoqërore, sipas legjislacionit për shërbimet shoqërore.

4. Përveç sa parashikohet në pikën 3 të këtij vendimi, ISHPSHSH-ja është përgjegjës për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për Inspektoratin Shtetëror që mbulon fushën e punës dhe atë të shërbimeve shoqërore.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ISHPSHSH-së

5. ISHPSHSH-ja organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal ku ky i fundit është për çdo qark të vendit.

6. ISHPSHSH-ja drejtohet nga kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit.

Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, kryeinspektori i ISHPSHSH-së ushtron këto kompetenca:

a) Përfaqëson ISHPSHSH-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe funksionimin, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHPSHSH-së.

b) Emëron dhe liron nga detyra personelin e ISHPSHSH-së, në dhe të degëve rajonale e vendore, në varësi të tij, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

c) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHPSHSH-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës.

ç) Nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të ISHPSHSH-së, në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në fushën e inspektimit të punës dhe shërbimeve shoqërore.

d) Bashkërendon veprimtarinë e ISHPSHSH-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e inspektimit të punës dhe shërbimeve shoqërore.

dh) Siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit të punës dhe shërbimeve shoqërore, si dhe



veprimtari të tjera, për plotësimin e detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin në punë dhe shërbimeve shoqërore.

e) Siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit në punë dhe shërbimeve shoqërore.

7. Kryeinspektori i ISHPSHSH-së i raporton drejtpërdrejt ministrit përgjegjës për punën dhe çështjet sociale, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatin e ministrisë përgjegjëse.

8. ISHPSHSH-ja, në nivel qendror, ka këto funksione:

a) planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit;

b) siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi;

c) informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;

ç) jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore, për veprimtarinë e inspektimit;

d) përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit;

dh) kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë.

9. Përcaktimi i subjekteve të parashikuara në shkronjën “dh” të pikës 9 të këtij vendimi, bëhet nga kryeinspektori, sipas metodologjisë së miratuar nga Inspektorati Qendror.

10. Përveç sa parashikohet në pikën 9 të këtij vendimi, ISHPSHSH-ja, në nivel qendror është përgjegjës për kryerjen e këtyre funksioneve të brendshme, për të gjithë institucionin, duke përfshirë edhe degët në nivel rajonal e vendor:

a) menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet ligjore, teknologjinë e informacionit, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse;

b) përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditivit të brendshëm.

11. Pranë ISHPSHSH-së në nivel qendror, krijohet “Komisioni i ankimit të ISHPSHSH-së”. Komisioni i ankimit drejtohet nga kryeinspektori dhe ka në përbërje:

a) një përfaqësues të njësisë që mbulon çështjet juridike;

b) një përfaqësues që mbulon çështjet e metodologjisë së inspektimit;

c) dy specialistë të tjerë të ISHPSHSH-së në nivel qendror.

12. Lista emërore e Komisionit të Ankimit miratohet me urdhër të Kryeinspektorit dhe bëhet publike me mjete të përshtatshme.

13. Degët rajonale të ISHPSHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në qarkun përkatës, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë vendim. Me urdhër të kryeinspektorit, inspektorët e një dege rajonale mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me degën rajonale përkatëse.

14. Dega rajonale e ISHPSHSH-së drejtohet nga kryeinspektori rajonal. Kryeinspektori rajonal përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

15. Përveç sa parashikohet në pikën 14 të këtij vendimi, kryeinspektori rajonal:

a) lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;

b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin;

c) vendos për zëvendësimin e inspektorëve, gjatë inspektimit, sipas ligjit;

ç) shqyrton ankimin e veçantë ndaj vendimeve për masat urgjente të marra nga inspektorët e degës përkatëse.

16. Kryeinspektori rajonal i raporton dhe i jep llogari drejtpërdrejt kryeinspektorit të ISHPSHSH-së, përveçse kur ky i fundit ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi pranë ISHPSHSH-së në nivel qendror.

17. Kryeinspektori propozon te ministri përgjegjës për çështjet e punës dhe shërbimeve sociale rregulloren e brendshme organizative për ushtrimin e veprimtarisë së ISHPSHSH-së.

IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE ISHPSHSH

18. ISHPSHSH-ja, identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

19. Stema e ISHPSHSH-së përbëhet nga Stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.

20. Vula e ISHPSHSH-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e ISHPSHSH-së në nivel qendror përmban dhe shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, ndërsa vulat e degëve rajonale përmbajnë dhe shënimin identifikues: “Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, dega rajonale e qarkut: (emri përkatës i qarkut)”, zyra vendore (emri përkatës i qarkut dhe rrethit).

21. Vula e ISHPSHSH-së dhe vulat e degëve rajonale e vendore prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

22. Ngarkohet ministri përgjegjës për punën dhe çështjet sociale që, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për realizimin e emërimit të kryeinspektorit të ISHPSHSH-së dhe përgatitjen e strukturës e të organikës së ISHPSHSH-së, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

23. Kryeinspektori i ISHPSHSH-së, mbështetur nga njësitë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe në përputhje me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve, të miratuara nga Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHPSHSH.

24. Nëpunësit që kryejnë funksionet e inspektimit të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, që janë aktualisht të emëruar pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përfshirë institucionet e saj të varësisë apo drejtoritë rajonale dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, si dhe kërkesat specifike të përcaktuara sipas pikës 23 të këtij vendimi, transferohen në detyra të reja pranë ISHPSHSH-së, brenda numrit dhe pozicioneve të organikës së miratuar sipas këtij vendimi.

25. Verifikimi i plotësimit të kërkesave të përgjithshme dhe atyre specifike sipas pikës 23 dhe propozimi i transferimit për çdo nëpunës, kryhet nga një komision *ad hoc* i krijuar posaçërisht për risistemimin e nëpunësve. Akti i transferimit miratohet nga kryeinspektori.

26. Komisioni *ad hoc* sipas pikës 25 të këtij vendimi, përbëhet nga dy përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike, dy përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, një përfaqësues nga Inspektorati Qendror dhe mbështetet në punën e tij nga njësi përgjegjëse për shërbimet mbështetëse në këtë ministri.

27. Nëpunësit ekzistues të përcaktuar sipas pikës 24 të këtij vendimi, që nuk mund të transferohet në ISHPSHSH, mbeten në institucionet përkatëse, të cilat riorganizohen brenda një periudhe 2-mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

28. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta përcakton dhe/apo propozon edhe rishpërndarjen e mjediseve e mjeteve të punës.



29. Çdo akt nënligjor në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 296, datë 3.4.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR INFORMACIONIN E THARËSEVE PËR
PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME KONSUMIN E ENERGJISË”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për informacionin e tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 qershor 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ Rregullorja e Parlamentit Europian nr. 392/2012, e datës 1 mars 2012 “Për informacionin e tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”, numri EUR-Lex 32012R0392, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L 123.

RREGULL TEKNIK

“PËR INFORMACIONIN E THARËSEVE PËR PËRDORIM SHTËPIAK NË LIDHJE ME KONSUMIN E ENERGJISË”

1 Përmbajtja dhe fusha e përdorimit

- 1.1. Ky Rregull Teknik përcakton kërkesat për etiketimin dhe informacionin plotësues për tharëset për përdorim shtëpiak që funksionojnë me energji elektrike, tharëseve me gaz dhe tharëseve të instaluar në një dollap, duke përfshirë edhe ato që shiten për përdorim jo-shtëpiak.
- 1.2. Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për makinat larëse për përdorim shtëpiak të kombinuara larje– tharje dhe paisjet për përdorim shtëpiak tharëse me centrifugim.

2. Përkufizime

Për qëllime të këtij Rregulli Teknik zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- 2.1 “tharëse për përdorim shtëpiak” është një pajisje ku tekstilet thahen duke u rrotulluar në një kazan cilindrik rrotullues në të cilin kalon ajër i nxehtë dhe që është projektuar për tu përdorur kryesisht për qëllime jo-profesionale (më poshtë referohet tharëse);
- 2.2 “tharëse e parashikuar për tu instaluar në një dollap” është një tharëse e parashikuar të instalohet në një dollap, zgavër e përgatitur më parë në mur ose vend i ngjashëm, që kërkon mbyllje të mobiluara;
- 2.3 “për përdorim shtëpiak e kombinuar larje-tharje” është një makinë larëse për përdorim shtëpiak që përfshin si procesin e tharjes me centrifugim ashtu dhe tharjen e tekstileve, zakonisht nëpërmjet ngrohjes dhe rrotullimit;
- 2.4 “tharëse me centrifugim”, e njohur komercialisht si “tharëse centrifugale” është një pajisje në të cilën uji largohet nga tekstilet nga veprimi centrifugal në një kazan cilindrik rrotullues dhe thahen nëpërmjet një pompe automatike e cila është projektuar të përdoret kryesisht për qëllime jo-profesionale;
- 2.5 “tharëse me ajër” është një tharëse që thith ajër të pastër, e kalon atë mbi tekstilet dhe nxjerr ajër me lagështi në dhomë ose jashtë;
- 2.6 “tharëse me kondesim” është një tharëse që ka një pajisje (duke përdorur kondesimin ose çdo mënyrë tjetër) për të hequr lagështinë nëpërmjet ajrit të përdorur në procesin e tharjes;
- 2.7 “tharëse automatike” është një tharëse që ndërpret procesin e tharjes kur konstaton një përmbajtje të caktuar të lagështisë në përmbajtjen e ngarkesës, për shembull përmes perçueshmisë ose ndjeshmërisë ndaj temperaturës;
- 2.8 “tharëse jo automatike” është një tharëse që ndërpret procesin e tharjes mbas një periudhe të paracaktuar, zakonisht e kontrolluar nga një matës kohe, por që mund të stakohet dhe në mënyrë manuale;
- 2.9 “program” është seria e operacioneve që janë të paracaktuara dhe të deklaruara nga furnizuesi si të përshtatshme për tharjen e disa llojeve të tekstileve;
- 2.10 “cikël” është procesi i i plote i tharjes sipas përcaktimit në programin e zgjedhur;
- 2.11 “kohëzgjatja e programit” është koha që kalon nga fillimi i programit deri në përfundim të tij, duke përfshirë çdo ndryshim në program të bërë nga përdoruesi i fundit;
- 2.12 “kapaciteti nominal” është masa maksimale në kilogram, e deklaruar nga furnizuesi, e shprehur në shumëfish të 0.5 kg të tekstileve të thata dhe të një lloji të caktuar që mund të



trajtohet në një tharëse sipas programit të zgjedhur, kur është e ngarkuar në përputhje me udhëzimet e furnizuesit;

2.13 “ngarkesë e pjesëshme” është gjysma e kapacitetit nominal e një tharëseje për një program të dhënë;

2.14 “efiçensa e kondesimit” është raporti ndërmjet masës së kondësuar të lagështisë në tharëset me kondësator dhe masës së lagështisë të larguar nga ngarkesa në fund të ciklit;

2.15 “gjëndje e stakuar” është një gjëndje ku tharësja fiket duke përdorur çelësa ose komanda të pajisjes, të parashikuara për operim nga përdoruesi i fundit gjatë përdorimit normal për të arritur konsumin më të ulët të energjisë që mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, ndërkohë që tharësja është e lidhur me burimin e energjisë dhe është përdorur në përputhje me udhëzimet e furnizuesit;

Kur nuk ka çelësa ose komanda të lejuara për përdoruesin e fundit, “gjëndje e stakuar” është gjëndja e arritur mbasi tharësja rikthehet vetë në një gjëndje të qëndrueshme të konsumit të energjisë;

2.16 “gjëndje e lënë ndezur” është gjëndja në fuqinë më të ulët që mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar mbas përfundimit të programit pa ndonjë ndërhyrje nga përdoruesi i fundit përveç shkarkimit të tharësës;

2.17 “tharëse e njëvlerëshme” është modeli i një tharëseje, e vendosur në treg me të njëjtin kapacitet nominal, karakteristika teknike dhe funksionimi, konsum të energjisë, sipas rastit efiçensë të kondesimit, kohëzgjatjen e programit standard për pambuk dhe emetimet e zhurmave akustike gjatë tharjes me një model tjetër të një tharëseje të vendosur në treg nga i njëjti furnizues por me një numër të ndryshëm të kodit tregtar;

2.18 “pikë shitje” është vëndi ku tharëset ekspozohen, ofrohen për shitje, qira apo blerje me këste;

2.19 “program standard pambuku” është cikli që than tekstilet e lara të pambukut nga përmbajtja fillestare e lagështisë në ngarkesë prej 60% deri në përmbajtjen e lagështisë 0 %.

3. Klasat e efiçensës së energjisë dhe klasat e efiçensës së kondesimit

3.1 Klasat e efiçensës së energjisë

Klasa e efiçensës së energjisë për një tharëse duhet të përcaktohet mbi bazën e Indeksit të Efiçensës së Energjisë (EEI) sipas përcaktimit në tabelën 1.

Indeksi i Efiçensës së Energjisë (EEI) i një tharëseje përcaktohet në përputhje me pikën 4.1

Tabela 1
Klasa e efiçensës së energjisë

Klasa e Efiçensës së Energjisë	Indeksi i Efiçensës së Energjisë
A+++ (më efiçente)	$EEI < 24$
A++	$24 \leq EEI < 32$
A+	$32 \leq EEI < 42$
A	$42 \leq EEI < 65$
B	$65 \leq EEI < 76$
C	$76 \leq EEI < 85$
D (më pak efiçente)	$85 \leq EEI$

3.2 Klasat e efijensës së kondesimit

Klasa e efijensës së kondesimit për një tharëse me kondesator përcaktohet mbi bazën e efijensës së ponderuar të kondesimit (Ct) si përcaktohet në tabelën 2.

Efijensa e ponderuar e kondesimit (Ct) për një tharëse me kondesator përcaktohet në përputhje me pikën 4.2.

Tabela 2

Klasat e efijensës së kondesimit

Klasa e efijensës së kondesimit	Efijensa e ponderuar e kondesimit
A (më efijente)	$t > 90$
B	$80 < t \leq 90$
C	$70 < Ct \leq 80$
D	$60 < t \leq 70$
E	$50 < t \leq 60$
F	$40 < Ct \leq 50$
G (më pak efijente)	$Ct \leq 40$

4. Metoda për llogaritjen e Indeksit të Efijensës së Energjisë dhe Efijensën e Ponderuar të Kondesimit

4.1 Llogaritja e Indeksit të Efijensës së Energjisë

Për llogaritjen e Indeksit të Efijensës së Energjisë (EEI) të modelit të një tharëseje bëhet duke krahasuar konsumin e ponderuar vjetor të energjisë për program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme me konsumin e saj standard vjetor të energjisë.

a) Indeksi i Efijensës së Energjisë (EEI) i rrumbullakosur deri në shifër pas presjes dhjetore, llogaritet si më poshtë:

$$EEI = AE C / SAE C \times 100\%$$

ku:

AE C = konsumi i ponderuar vjetor i energjisë i tharëses.

SAE C = konsumi standard vjetor i energjisë.

b) Konsumi standard vjetor i energjisë (SAE C) në kW orë/vit i rrumbullakosur me dy presje dhjetore llogaritet si më poshtë:

— për të gjitha tharëset që nuk janë me ajër:

$$SAE C = 140 \times c \times 0,8$$

— për tharëset me ajër:

$$SAE C = 140 \times c \times 0,8 - \{30 \times Tt/60\};$$

ku:

c = kapaciteti nominal i tharëses për program standard pambuku.



T_t = kohëzgjatja e ponderuar e programit

c) Konsumi i ponderuar vjetor i energji (AE C) në kW orë/vit i rumbullakosur deri dy shifra pas presjes dhjetore llogaritet si më poshtë:

$$(i) \quad AEC = \frac{E_t \times 160 + [Po \times 525600 - (T_t \times 162)/2 + Pl \times 52560 - (T_t \times 160)/2]}{60 \times 1000}$$

ku:

E_t = konsumi i ponderuar i energji, në kW orë i rumbullakosur deri dy shifra pas presjes dhjetore.

P_o = fuqia në "gjendje të stakuar" për programin standard pambuk i rumbullakosur deri dy shifra pas presjes dhjetore.

P_l = fuqia në "gjendjen e lënë ndezur" për programin standard pambuk në ngarkesë të plote i rumbullakosur deri dy shifra pas presjes dhjetore.

T_t = kohëzgjatja e ponderuar e programit në minuta e rumbullakosur në minutën më të afërt.

160 = numri i përgjithshëm i cikleve të tharjes në vit.

(ii) Kur tharësja është e pajisur me një sistem të manaxhimit të fuqisë që e rikthen automatikisht në gjendje të stakuar mbas mbarimit të programit, konsumi i ponderuar vjetor i energjisë (AE C) llogaritet duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen efektive të gjëndjes së lënë ndezur sipas formulës së mëposhtme:

$$AEC = \frac{E_t \times 160 + \{(Pl \times T_l \times 160) + P_o \times [525600 - (T_t \times 160) - (T_l \times 160)]\}}{60 \times 1000}$$

ku:

T_l = kohëzgjatja në minuta në gjendjen e lënë ndezur për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë rumbullakosur me minutën më të afërt.

ç) Kohëzgjatja e ponderuar e programit (T_t) në minuta për programin standard pambuk rumbullakosur me minutën më të afërt llogaritet si më poshtë:

$$T_t = (3 \times T_{dry} + 4 \times T_{dry}^{1/2})/7$$

ku:

T_{dry} = kohëzgjatja e programit për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë rumbullakosur në minutën më të afërt.

$T_{dry}^{1/2}$ = kohëzgjatja e programit për programin standard pambuk në ngarkesë të pjesëshme rumbullakosur me minutë më të afërt.

d) Konsumi i ponderuar i energjisë (E_t) në kW orë, i rumbullakosur deri dy shifra pas presjes dhjetore llogaritet si më poshtë:

$$E_t = (3 \times E_{dry} + 4 \times E_{dry}^{1/2})/7$$

ku:

Edry = konsumi i energjisë në programin standard pambuk në ngarkesë të plotë, në kWorë rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

Edry^{1/2} = konsumi i energjisë në programin standard pambuk në ngarkesë të pjesëshme, në kWorë rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

dh) Për tharëset me gaz, konsumi i energjisë për programin standard pambuk në ngarkesë të plote dhe të pjesëshme në kWorë rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore llogaritet si:

$$Edry = Egdr/fg + Egdry.a$$

$$Edry^{1/2} = Egdry^{1/2}/fg + Egdry^{1/2}.a$$

ku:

Egdr = konsumi i gazit për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë në kWorë rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

Egdry^{1/2} = konsumi i gazit për programin standard pambuk në ngarkesë të pjesëshme në kWorë rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

Egdry.a = konsumi i energjisë elektrike ndihmëse në programin standard pambuk në kWorë në ngarkesë të plotë rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

Egdry^{1/2}.a = konsumi i energjisë elektrike ndihmëse në programin standard pambuk në kWorë në ngarkesë të pjesëshme rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore.

fg = 2.5

4.2. Llogaritjet lidhur me informacionin e produktit të përshkruar në pikën 7 “Skeda informative e produktit”, në pikën 5 “Dokumentacioni teknik” dhe në pikën 8 “Informacioni që sigurohet në rastet kur përdoruesit e fundit nuk mund të shikojnë shfaqjen e produktit”.

Për tharëset me gaz, konsumi i energjisë mbi gaz për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme për informacionin në pikat 4, 5 dhe 6, llogaritet në kWorë gaz dhe rumbullakoset deri në dy shifra pas presjes dhjetore, sipas formulës:

$$AE C(Gas) = 160 \times (3 \times Edry + 4 \times Edry^{1/2}) / 7$$

Për tharëset me gaz, konsumi i energjisë elektrike për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme për informacionin në pikat 7 dhe 8, llogaritet në kWorë dhe rumbullakoset deri në dy shifra pas presjes dhjetore sipas formulës:

$$AE C(Gas)_{el} = 160 \times (3 \times Egdry.a + 4 \times Egdry^{1/2}.a) / 7 + ((P_l \times T_l \times 160) + P_o \times [525\,600 - (T_t \times 160) - (T_l \times 160)]) / 60 \times 1\,000$$

4.3 Llogaritja efiçensës së ponderuar të kondesimit.

Efiçenca e kondesimit për një programi është raporti ndërmjet masës së lagështisë së kondësuar të mbledhur në rezervuarin e një tharëseje me kondesator me masën e lagështisë të çvendosur sipas programit nga ngarkesa, të qëniti si diferencë ndërmjet masës së lagështisë të ngarkesës para tharjes dhe masës së testuar mbas tharjes. Në llogaritjen e efiçensës së ponderuar të kondesimit



merret në konsideratë efijënca e kondesimit mesatar për programin standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme.

Efijënca e pënderuar e kondesimit (C_t) për një program llogaritet si % e rrumbullakosur me përqindjen e plotë më të afert si

$$C_t = (3 \times C_{dry} + 4 \times C_{dry\frac{1}{2}}) / 7$$

ku:

C_{dry} = efijënca e pënderuar e kondesimit për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë.

$C_{dry\frac{1}{2}}$ = efijënca e pënderuar e kondesimit për programin standard pambuk në ngarkesë të pjesëshme.

Efijënca e pënderuar C e kondesimit llogaritet nga efijëncat e kondesimit të testeve të kryera e shprehur si përqindje:

$$C = 1/n - 1 \sum_{j=2}^n (W_{wj}/W_i - W_j \times 100)$$

ku:

n = numri i testeve të kryera, duke krahasuar së paku për katër teste të vlefshme për programin e zgjedhur.

j = numri i testit të kryer.

W_{wj} = masa e ujit e mbledhur në rezervuarin e kondesatorit gjatë testit j .

W_i = masa e ngarkesës së testuar përpara tharjes.

W_f = masa ngarkeses së testuar mbas tharjes.

5. Dokumentacioni teknik

Furnizuesi ve dokumentacionin teknik në dispozicion të Strukturës Përgjegjëse të Mbikqyrjes së Tregut, me kërkesë të saj.

5.1 Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë:

a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

b) një përshkrim të përgjithëm të modelit të tharëses për aq sa ai të jetë qartësisht dhe lehtësisht i identifikuar;

c) sipas rastit, referimet e standardeve të harmonizuara të zbatuar;

ç) sipas rastit, standardet dhe specifikimet e tjerë teknike të përdorura;

d) identifikimin dhe firmën e personit të autorizuar të lidhur me furnizuesin;

dh) parametrat teknike për matjet si më poshtë:

(i) për tharëset që funksionojnë me energji elektrike:

- konsumin e energjisë (E_{dry} , $E_{dry\frac{1}{2}}$, E_{gdry} , $E_{gdry\frac{1}{2}}$, $E_{gdry.a}$, $E_{gdry\frac{1}{2}.a}$ për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë dhe në ngarkesë të pjesëshme,

për tharëset me gaz:

- konsumin e pënderuar vjetor të energjisë ($AE C(gaz)$) rrumbullakosur deri në një shifer pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si "konsumi i energjisë 'X' kWorë gaz për vit, i bazuar në 160 cikle tharje në program standard pambuk në ngarkesë të plotë dhe në ngarkesë të pjesëshme. Konsumi aktual i energjisë për cikël varet se si përdoret pajisja;

dhe

- konsumin e pënderuar vjetor të energjisë elektrike ($AE C(gaz)_{el}$) rrumbullakosur deri në një shifer pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si "konsumi i energjisë 'X' kWorë gaz për vit, i

e) rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me pikën 4.

Informacioni gjithashtu duhet të përfshijë një listë të të gjithë modeleve të tjera të njëvlerëshme të tharëseve, kur informacioni është i siguruar mbi atë bazë.

Furnizuesi siguron që çdo tharëse ka etiketën sipas kërkesave të këtij Rregulli Teknik dhe tregtarët sigurojnë që çdo tharëse në pikën e shitjes ka të vendosur etiketën, në pjesën e jashtme të përparme ose në pjesën më të sipërme të saj, në atë mënyrë që ajo të jetë qartësisht e dukshme.

The image shows a standard European Energy Label for a washing machine. The label is rectangular with a light blue background and a dark blue header. The header contains the European Union flag on the left and the word "ENERGY" in large, bold, white letters. Below "ENERGY" are the words "ЭНЕРГИЯ" (Russian) and "енергія" (Ukrainian). To the right of the header is a yellow box with the letters "Y" and "A" in black, and another yellow box with the letters "IE" and "A" in black. Below the header is a large, dark blue arrow pointing to the right, with the letter "A" in white. To the left of the arrow are four horizontal bars of increasing length, labeled "A++", "A+", "B", and "C" from top to bottom. Below the arrow is a yellow box with the text "XYZ kWh/annum". Below this box are four icons in a row: a washing machine, a clock, a water drop, and a speaker. Below each icon is a label: "XYZ min/cycle*", "Y,Z kg", and "XX dB". At the bottom of the label is a small line of text: "Figures are approximate. Actual figures may vary depending on the use of the appliance. For more information, please refer to the user manual." Below this line is the number "2000000000".

ENERGIA · ЕНЕРГИЯ · ЕНЕРГІЯ
ENERGIA · ENERGY · ЕНЕРГІЯ
ENERGY

XYZ kWh/annum

XYZ min/cycle*

Y,Z kg

XX dB

*Figures are approximate. Actual figures may vary depending on the use of the appliance. For more information, please refer to the user manual.

2000000000



a) Etiketa përfshin informacionin e mëposhtëm:

I. emrin e furnizuesit ose markën tregtare;

II. identifikimin e modelit nga furnizuesi që nënkupton kodin, zakonisht alfanumerik, që dallon një model specifik të tharëses nga modele të tjerë me të njëjtën markë tregtare ose emër të furnizuesit;

III. klasën e efijensës së energjisë e përcaktuar në pikën 8.1. Drejtimi i shigjetës që përmban klasën e efijensës së energjisë të tharëses duhet të vendoset në të njëjtën lartësi me drejtimin e shigjetës të klasës përkatëse të energjisë;

IV. konsumin e ponderuar vjetor të energjisë (AE C) në kWorë për vit, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 9;

V. informacion mbi tipin e tharëses;

VI. kohëzgjatjen në minuta të ciklit që i korespondon programit standard pambuk në ngarkesë të plotë dhe rrumbullakosur në minutën më të afërt;


VII. kapacitetin nominal në kg për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë;

VIII. nivelin e emetimeve të zhurmës akustike (vlera mesatare e ponderuar – L_{WA}) gjatë fazës së tharjes për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë, e shprehur në dB dhe e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,

b) karakteristikat e dizenjimit të etiketës për tharëset me ajër duhet të jenë në përputhje me pikën 6.4.

Një kopje e etiketës EU Eco mund të shtohet kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës.

6.2 Etiketa për tharëset me kondesim




Etiketa për tharëset me kondesim, përveç informacionit të dhënë në pikën 6.1, duhet të përfshijë:

a) klasën e efijensës së kondesimit në përputhje me pikën 8.2.

b) një kopje e etiketës EU Eco mund të shtohet kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës.


6.3. Etiketa për tharëset me gaz



- Informacioni i dhënë në pikën 6.1a) duhet të përfshihet në etiketën për tharëset me gaz;
- një kopje e etiketës EU Eco mund të shtohet kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës

6.4. Karakteristikat e dizenjimit të etiketës

6.4.1 Formati i etiketës për tharëset me ajër është si në figurën e mëposhtme:





Ku

- a) Etiketa duhet të jetë së paku 110 mm e gjërë dhe 220 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të jetë në perpjestim me specifikimet e mësipërme.
- b) Sfondi duhet të jetë i bardhë.
- c) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – e kalter, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shembull 00-70-X-00: e kalter 0 %, e kuqe e purpurt 70 %, e verdhë 100 %, e zezë 0 %.
- c) Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

- 1 Korniza e jashme e etiketës EU:** 5 pt, ngjyra e kaltër 100 %, rakordimet nënde 3.5 mm.
- 2 Logo EU:** ngjyrat: X-80 -00- 00 dhe 00-00-X-00.
- 3 Etiketa e energjise:** ngjyra X-00-00-00. Piktograma e vizatuar: EU logo dhe logo e energjise (së bashku); gjërësia 92 mm, lartësia 17 mm.
- 4 Kufiri i nen logove:** 1pt, ngjyra e kaltër 100 %, gjatësia 92.5 mm.
- 5 Shkalla A- G**
 - **Shigjeta:** lartësia 7 mm, hapësira 0.75 mm, ngjyrat:
Klasa më e lartë: X-00-X-00,
Klasa e dytë: 70-00-X-00,
Klasa e tretë: 30-00-X-00,
Klasa e katërt: 00-00-X-00,
Klasa e pestë: 00-30-X-00,
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
Klasa e fundit: 00-X-X-00.
 - **Teksti:** Kalibri bold 18 pt; gërma kapitale dhe të bardha; simbolet ‘+’ kalibri bold 12 pt, të bardha, të vendosura vetëm në një rresht.
- 6 Klasa e efijensës së energjisë**
 - **Shigjeta:** gjatësia 26 mm, lartësia: 14 mm, 100 % e zezë;
 - **Teksti:** Kalibri bold 29 pt kapitale të bardha, simbolet ‘+’: Kalibri bold 18 pt, të bardhë e vendosur vetëm në një rresht.
- 7 Energjia**
 - **Teksti:** Kalibër i rregullt 11 pt, kapitale, 100 % e zezë.
- 8 Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë:**
 - **Korniza:** 2 pt, ngjyra e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
 - **Vlera:** Kalibri bold 30 pt, 100 % e zezë.
 - **Linja e dyte:** Kalibër i rregullt 14 pt, 100 % e zezë.
- 9 Tipi i tharësës:**
 - **Piktograma si e vizatuar**
 - **Korniza:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
- 10 Kohëzgjatja e ciklit:**
 - **Piktograma si e vizatuar**
 - **Korniza:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
 - **Vlera:** Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.

11 Kapaciteti nominal:

— Piktograma si e vizatuar

— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100%, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

— Vlera: Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.

12 Niveli i emetimit të zhurmës:

— Piktograma si e vizatuar

— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

— Vlera: Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.

13 Shënimi me yll:

Kalibri i rregullt 6 pt, 100 % e zezë.


14 Emri ose marka tregtare e furnizuesit

15 Identifikimi i modelit tefurnizuesit

16 Emri ose marka tregtare e furnizuesit dhe identifikimi i modelit vendosen në hapësirën 92 × 15 mm.

17 Numri i rregullit teknik/rregullores perkatese europiane: Kalibri bold 9 pt, 100 % e zezë.

6.4.2 Format i etiketës për tharëset me kondesim është si në figurën e mëposhtme:





Ku:

- a) Etiketa duhet të jetë së paku 110 mm e gjërë dhe 220 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të jetë në përpjestim me specifikimet e mësipërme.
- b) Sfondi duhet të jetë i bardhë.
- c) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shembull 00-70-X-00: e kaltër 0 %, e kuqe e purpurt 70 %, e verdhë 100 %, e zezë 0 %.
- ç) Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1 Korniza e jashme e etiketes: 5 pt, ngjyra e kaltër 100 %, rakordimet në kënde 3.5 mm.

2 Logo EU: ngjyrat: X-80 -00- 00 dhe 00-00-X-00.

3 Etiketa e energjisë: ngjyra X-00-00-00. Piktograma si e vizatuar: EU logo dhe logo e energjisë (se bashku); gjërësia 92 mm, lartësia 17 mm.

4 Kufiri i nën logove:
1pt, ngjyra e kaltër 100 %, gjatësia 92.5 mm.

5 Shkalla A- G
— **Shigjeta:** lartësia 7 mm, hapësira 0.75 mm, ngjyrat:
Klasa më e lartë: X-00-X-00,
Klasa e dytë: 70-00-X-00,
Klasa e tretë: 30-00-X-00,
Klasa e katërt: 00-00-X-00,
Klasa e pestë: 00-30-X-00,
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
Klasa e fundit: 00-X-X-00.

— **Teksti:** Kalibri bold 18 pt, gërma kapitale dhe të bardha, simbolet ‘+’ kalibri bold 12 pt—të bardha, të vendosura vetëm në një rresht.

6 Klasa e efikasitetit të energjisë
— **Shigjeta:** gjatësia 26 mm, lartësia: 14 mm—100 % e zezë;
— **Teksti:** Kalibri bold 29 pt— kapitale dhe të bardha—simbolet ‘+’: Kalibri bold 18 pt, e bardhë, e vendosur vetëm në një rresht.


7 Energjia
— **Teksti:** Kalibri i rregullt 11 pt, kapitale, 100 % e zezë.

8 Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë:
— **Korniza:** 2 pt, ngjyra e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
— **Vlera:** Kalibri bold 30 pt, 100 % e zezë.
— **Linja e dyte:** Kalibër i rregullt 14 pt, 100 % e zezë.

- 9 Tipi i tharëses:**
— Piktograma si e vizatuar
— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
- 10 Kohëzgjatja e ciklit: |**
— Piktograma si e vizatuar
— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
— Vlera: Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.
- 11 Kapaciteti nominal:**
— Piktograma si e vizatuar
— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100%, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
— Vlera: Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; dhe Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.
- 12 Niveli i emetimeve të zhurmës:**
— Piktograma si e vizatuar
— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.
— Vlera: Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; dhe Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.
- 13 Shënimi me yll:**
Kalibri i rregull 6 pt, 100 % e zeze.
- 14 Emri ose marka tregtare e furnizuesit**
- 15 Identifikimi i modelit tefurnizuesit**
- 16** Emri ose marka tregtare e furnizuesit dhe identifikimi i modelit vendosen në hapësirën 92 × 15 mm.
- 17** Numri i rregullit teknik/rregullores perkatese europiane: Kalibri bold 9 pt, 100 % e zezë.
- 18 Klasa e efijensës së kondesimit:**
Piktograma si e vizatuar
— Korniza: 2 pt, ngjyra: e kaltër 100%, rakordimet në kënde 3,5 mm.
— Vlera: Kalibri i rregullt 16 pt, shkalla horizontale 75 %, 100 % e zezë dhe Kalibri bold 22 pt, shkalla horizontale 75%, 100% e zezë.



6.4.3 Formati i etiketës për tharëset me gaz është si në figurën e mëposhtme:



Ku:

- Etiketa duhet të jetë së paku 110 mm e gjërë dhe 220 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, ërmbajtja e saj duhet të jetë në përpjestim me specifikimet e mësipërme.
- Sfondi duhet të jetë i bardhë.
- Ngjyrat duhet të jenë CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shembull 00-70-X-00: e kaltër 0 %, e kuqe e purpurt 70 %, e verdhë 100 %, e zezë 0 %.
- Etiketa duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1 Korniza e jashtme e etiketës:

5 pt, ngjyra e kaltër 100 %, rakordimet në kënde 3.5.mm.

2 Logo EU: ngjyrat: X-80 -00- 00 dhe 00-00-X-00.

3 Etiketa e energjise: ngjyra X-00-00-00. Piktograma si e vizatuar: EU logo dhe logo e energjisë (së bashku); gjerësia 92 mm, lartësia 17 mm.

4 Kufiri i nën logove:

1pt, ngjyra e kaltër 100 %, gjatësia 92.5 mm.

5 Shkalla A- G

— Shigjeta: lartësia 7 mm, hapësira 0.75 mm, ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00,

Klasa e dytë: 70-00-X-00,

Klasa e tretë: 30-00-X-00,

Klasa e katërt: 00-00-X-00,
Klasa e pestë: 00-30-X-00,
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
Klasa e fundit: 00-X-X-00.

— **Teksti:** Kalibri bold 18 pt, gërma kapitale dhe të bardha, simbolet ‘+’ kalibri bold 12 pt, të bardha dhe të vendosura vetëm në një rresht.

6 Klasa e efikasitetit të energjisë

— **Shigjeta:** gjatësia 26 mm, lartësia: 14 mm, 100 % e zezë;

— **Teksti:** Kalibri bold 29 pt, kapitale dhe të bardha, simbolet ‘+’: Kalibri bold 18 pt, e bardhë dhe e vendosur vetëm në një rresht.

7 Energjia

— **Teksti:** Kalibri i rregullt 11 pt, kapitale, 100 % e zezë.

8 Konsumi i ponderua vjetor i energjisë elektrike:

— **Korniza:** 2 pt, ngjyra e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

— **Vlera:** Kalibri bold 30 pt, 100 % e zeze.

— **Linja e dyte:** Kaliber i rregullt 14 pt, 100 % e zeze.

9 Tipi i tharës:

— **Piktograma si e vizatuar**

— **Korniza:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

10 Kohëzgjatja e ciklit:

— **Piktograma si e vizatuar**

— **Korniza:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

— **Vlera:** Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.

11 Kapaciteti nominal:

— **Piktograma si e vizatuar**

— **Korniza:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

— **Vlera:** Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; dhe Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.

12 Niveli i emetimeve të zhurmës:

— **Piktograma si e vizatuar**

— **Korniza:** 2 pt, ngjyra: e kaltër 100 %, rakordimet në kënde: 3,5 mm.

— **Vlera:** Kalibri bold 24 pt, 100 % e zezë; dhe Kalibri i rregullt 16 pt, 100 % e zezë.

13 Shenimi me yll:

Kalibri i rregullt 6 pt, 100 % e zezë.

14 Emri ose marka tregtare e furnizuesit

15 Identifikimi i modelit të furnizuesit

16 Emri ose marka tregtare e furnizuesit dhe identifikimi i modelit vendosen në hapësirën 92 × 15 mm.

17 Numri i rregullit teknik/rregullores perkatëse europiane:

Kalibri bold 9 pt, 100 % e zezë.



7. Skeda informative e produktit

Furnizuesi bën të disponueshme skedën informative të produktit

7.1 Informacioni i dhënë në skedën informative të tharëseve duhet të përfshihet në broshurën e produktit ose në çdo dokumentacion tjetër që shoqëron produktin sipas renditjes së mëposhtme:

- a) emri i furnizuesit ose marka tregtare;
- b) identifikimi i modelit të furnizuesit që nënkupton kodin, zakonisht alfanumerik, që dallon një model specifik të tharëses nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose emër të furnizuesit,
- c) kapaciteti nominal në kg i tekstilevetë lara për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë,
- ç) tregim nëse tharësja është me ajër, me kondesim ose me gaz;
- d) klasa e efijensës së energjisë në përputhje me pikën 3.1;
- e) për tharëset që funksionojnë me energji elektrike:

Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë elektrike (AE C) rrumbullakosur në një shifër pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si “konsumi i energjisë ‘X’ në kWorë për vit, i bazuar në 160 cikle tharje në program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme, dhe konsumi në gjëndjet e fuqisë së ulët. Konsumi aktual i energjisë për cikël varet se si përdoret pajisja;

për tharëset me gaz:

Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë (AE C(gaz)) rrumbullakosur në një shifër pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si “konsumi i energjisë ‘X’ në kWorë gaz për vit, i bazuar në 160 cikle tharje në program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme.

Konsumi aktual i energjisë për cikël varet se si përdoret pajisja;

dhe

konsumi i ponderuar vjetor i energjisë elektrike (AE C(gaz)el) rrumbullakosur në një shifër pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si “konsumi i energjisë ‘X’ në kWorë gaz për vit, i bazuar në 160 cikle tharje në program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme dhe konsumin në gjëndjet e fuqisë së ulët. Konsumi aktual i energjisë për cikël varet se si përdoret pajisja;

ë) tregimi nëse tharësja është “tharëse automatike” ose “tharëse jo automatike”;

f) mund të përfshihet informacioni nëse tharësja ka etiketën EU Eco sipas legjislacionit përkatës;

g) konsumi i energjisë (Edry, Edry½, Egdry, Egdry½, Egdry.a, Egdry½.a) në program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme;

gj) fuqia në gjëndje të stakuar (*P_o*) dhe në gjëndjen e lënë ndezur (*P_I*) për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë;

h) kohëzgjatja e gjëndjes së lënë ndezur, nëse tharësja është e pajisur me sistemin e manaxhimit të fuqisë;

i) treguesin që “programi standard i pambukut” i përdorur në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme është programi standard i tharjes i relatuar në informacionin në etiketë dhe në skedën informative dhe që ky program është i përshtatshëm për tharje normale të tekstileve prej pambuku dhe që është programi më efijent në termat e konsumit të energjisë për tekstilet prej pambuku;

j) kohëzgjatja e ponderuar e programit (*T_t*) për “programin standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme” në minuta, rrumbullakosur në minuten më të afërt si dhe kohëzgjatjen e programit “programin standard pambuk në ngarkesë të plotë(*T_{dry}*) dhe kohëzgjatja e programit

për programin standard pambuk në ngarkesë të pjesëshme” ($T_{dry}/2$) në minuta rumbullakosur në minutën më të afërt;

k) nëse tharësja është tharëse me kondesator, klasa e efijensës së kondesimit në përputhje me pikën 3.2, e shprehur si “klasa e efijensës së kondesimit ‘X’ në shkallën nga G (efijensa më e ulët) deri në A (efijensa më e lartë)”. Kjo mund të shprehet në mënyra të tjera duke qartësuar se shkalla është nga G (efijensa më e ulët) deri në A (efijensa më e lartë);

l) nëse tharësja është tharëse me kondesator, efijensa mesatare e kondesimit C_{dry} dhe $C_{dry}/2$ e programit standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe në ngarkesë të pjesëshme dhe efijensa mesatare e kondesimit (C_I) për programin standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme jepet si përqindje e rumbullakosur në përqindjen më të afërt;

ll) niveli i emetimit të zhurmës (vlera e mesatare e ponderuar - L_{WA}) e shprehur në dB rumbullakosur në numrin më të afërt për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë;

m) një tregues nëse tharësja është parashikuar të instalohet në një dollap.

7.2 Skeda informative mund të mbulojë disa modele tharësesh të furnizuara nga i njëjti furnizues.

7.3 Informacioni i dhënë në skedën informative mund të jepet në formën e një kopje të etiketës me ngjyra ose në të zezë dhe të bardhë. Në këtë rast duhet të jepet informacioni i listuar në pikën 7.1.

8. Informacioni që sigurohet në rastet kur nuk pritet që përdoruesit e fundit të shikojnë shfaqjen e produktit

8.1 Informacioni duhet të jepet sipas renditjes së mëposhtme:

a) kapaciteti nominal në kg pambuk për program standard pambuku në ngarkesë të plotë;

b) tregimi nëse tharësja është tharëse me ajër, tharëse me kondesator apo tharëse me gaz;

c) klasa e efijensës së energjise siç përcaktohet në pikën 3.1;

ç) për tharëset që operojnë me energji elektrike:

Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë elektrike (AE_C) i rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Ai përshkruhet si “konsumi i energjise ‘X’ në kWorë për vit, i bazuar në 160 cikle tharje për program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe konsumin në gjëndjen e fuqisë së ulët. Konsumi aktual i energjisë për cikël varet se si përdoret pajisja”;

për tharëset me gaz:

Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë ($AE_{C(gaz)}$) i rumbullakosur deri në një shifër pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si “konsumi i energjisë ‘X’ kWorë gaz për vit, i bazuar në 160 cikle tharje në program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe të pjesëshme. Konsumi aktual i energjise për cikël varet se si përdoret pajisja”;

dhe

konsumi i ponderuar vjetor i energjisë elektrike ($AE_{C(gaz)el}$) i rumbullakosur deri në një shifër pas presjes dhjetore. Ai përshkruhet si “konsumi i energjise ‘X’ kWorë gaz për vit, i bazuar në 160 cikle tharje për program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe në ngarkesë të pjesëshme dhe konsumin në gjëndjen e fuqisë së ulët. Konsumi aktual i energjisë për cikël varet se si përdoret pajisja”;

d) tregimin nëse tharësja është “tharëse automatike” ose “tharëse jo automatike”;



- dh)** konsumi i energjisë (Edry, Edry $\frac{1}{2}$, Egdry, Egdry $\frac{1}{2}$, Egdry.a, Egdry $\frac{1}{2}$.a) për program standard pambuku në ngarkesë të plotë dhe ngarkesë të pjesëshme rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore dhe llogaritur në përputhje me pikën 4;
- e)** fuqinë në gjëndjen e stakuar (*Po*) dhe në gjëndjen e lënë ndezur (*Pl*) për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë;
- ë)** kohëzgjatja e programit standard pambuk në ngarkesë të plotë (*Tdry*) dhe kohëzgjatja e programit në programin standard pambuk në ngarkesë të pjesëshme (*Tdry $\frac{1}{2}$), rumbullakosur në minutën më të afërt dhe llogaritur në përputhje me pikën 4 ;*
- f)** klasa e efijensës së kondesimit në përputhje me pikën 3.2 nëse tharësja është tharëse me kondesator;
- g)** nivelin e emetimit të zhurmës (vlera e mesatare e ponderuar – LWA) për programin standard pambuk në ngarkesë të plotë e shprehur në dB dhe rumbullakosur në numrin më të afërt;
- gj)** shtohet një tregues, nëse tharësja është e parashikuar të instalohet në një dollap

8.2 Madhësia dhe forma e shkronjave për informacionin e referuar në këtë pikë duhet të jenë qartësisht të lexueshëm kur printohen ose tregohen, minimalisht: time new romans, me madhësi të gjërave 12.

8.3. Çdo publicitet ose material promovues teknik që i përket një modeli specifik të tharësës dhe që përshkruan parametra specifike teknike duhet të përfshijë klasën efijensës së energjisë së këtij modeli.

9. Proçedura e verifikimit për qëllime të mbikqyrjes së tregut.

Struktura Përgjegjëse e Mbikqyrjes së Tregut duhet të përdorë proçedura të besueshme, të sakta dhe të ripërsëritshme të matjeve që marrin parasysh metodat përgjithësisht të pranuar bashkohore, duke përfshirë dhe metodat e përcaktuara në dokumeta/standarde, numrat e referimit të të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare.

Për qëllime të kontrollit të përputhshmërisë, SPMT duhet të testojë një tharëse. Nëse parametrat e matur nuk plotësojnë vlerat e deklaruara nga furnizuesi brenda vlerave të dhëna në tabelën 1, matjet duhet të kryhen në tre tharëse të tjera. Mesatarja arithmetike e vlerave të matura të këtyre tre tharësive duhet të jete brenda intervaleve të deklaruara nga furnizuesi brenda intervaleve të përcaktuara në tabelën 1.

Në të kundert, modeli dhe të gjithë modelet e njëvlerëshme të tharësive konsiderohen në mospërputhje me kërkesat.

Tabela 1

Parametri i matur	Tolerancat e verifikimit
Konsumi i ponderuar vjetor i energjisë	Vlera e matur nuk duhet të jetë më e madhe se 6% e vlerës nominale <i>AE C</i> .
Konsumi i ponderuar i energjisë.	Vlera e matur nuk duhet të jetë më e madhe se 6% e vlerës nominale <i>Et</i> .
Efijensa e	Vlera e matur nuk duhet të jetë më e ulët se 6% e vlerës

ponderuar e kondesimit	nominale Ct.
Kohëzgjatja e ponderuar e programit	Vlera e matur nuk duhet të jetë më e madhe se 6% e vlerës nominale Tt.
Fuqia në gjendje të stakuar dhe të lënë ndezur	Vlera e matur e e fuqisë <i>Po</i> dhe <i>Pl</i> për më shumë se 1,00W nuk duhet të jetë më e madhe se 6%. e vlerës nominale. Vlera e matur e fuqisë <i>Po</i> dhe <i>Pl</i> për më pak ose të barabartë me 1,00 W nuk duhet të jetë më e madhe se 0,10 W e vlerës nominale.
Kohëzgjatja në gjëndjen e lënë ndezur	Vlera e matur nuk duhet të jetë më e madhe se 6% e vlerës nominale Tl.
Niveli i emetimeve të zhurmës akustike L WA	Vlera e matur nuk duhet të jetë më e madhe se vlera nominale.
(*) ‘Vlerë nominale’ është vlera e deklaruar nga furnizuesi. Ndryshimi 6% në matje paraqet gabimin e pranuar gjatë testimit laboratorik të matjes të parametrave të deklaruar me metodën e re të përdorur lidhur me kërkesat në projektim të etiketës/eko duke përfshirë ciklet në ngarkesë të plotë dhe në ngarkesë të pjesëshme	

VENDIM

Nr. 297, datë 10.4.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 17, DATË 21.1.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDEVE PUBLIKE PËR VEPRIMTARI SPECIFIKE, OPERATIVE, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 10 të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës “d” të pikës 1 të vendimit nr. 17, datë 21.1.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) krijimin dhe administrimin e pasurive dhe të aktiviteteve ekonomike në funksion të realizimit të detyrave. Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive dhe aktiviteteve ekonomike me qëllim kamuflimi do të përdoren sipas kësaj pike të vendimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 298, datë 10.4.2013

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E TË
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e z. Gjergji Xhuveli anëtar të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për një mandat 4-vjeçar.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 299, datë 10.4.2013

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 74, DATË 1.2.2013 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË
SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, PATOS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 74, datë 1.2.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhet një ndryshim dhe një shtesë:

1. Pika 2 shfuqizohet.
 2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“3. Mbyllet e procedurave të privatizimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos.”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 300, datë 10.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “MERKO” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Merko” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “Erdo Construction” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Merko”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 303, datë 10.4.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z. GENTIAN DEMALIAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z. Gentian Demaliaj.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 305, datë 10.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS MUHURR TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Muhurr të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Muhurr të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr. 760, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Muhurr të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Muhurr për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Muhurr

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
3	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administrative	Në pronësi
4-6	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
7,8,10,11,13,14,16-18,20,22,24,25,26/1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë-ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Nuk transferohen sipërfaqet e trajtuara me vendimin nr. 868, datë 18.6.2008
9,12,15,19,21,23,26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë-ushqimit. Toka pa frute (ledhe)	Në pronësi
27-34	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e arsimit	Në pronësi
313-323	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
326-334	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e infrastrukturës rrugore	Në pronësi
335-338	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 306, datë 10.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS RRAPE TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Rrape të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr. 1 e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Rrape të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr. 246, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Rrape të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Rrape për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Rrape

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
488	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
489-501	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
502-506	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
513-520	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
532-550,553-571	Prona që përdoren në ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
572-588	Varrezat publike	Në pronësi
589-599	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
602-609,610-659	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
660	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes kombëtare	
661-686	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi



VENDIM
Nr. 308, datë 10.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 1719, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45 të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregullat e ankandit publik, miratuar me vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kreun VI “Kushte të përgjithshme për zbatim”, në pikën 6 shkronja “c”, ndryshohet dhe pas saj shtohet shkronja “ç”, si më poshtë vijon:

“c) Kur për objektet e ankandit të shpallura dy herë për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerjen e tyre, autoriteti shitës cakton një VAM tjetër më të ulët se VAM-i fillestar. Ulja e VAM-it bëhet 20%.

ç) Në procedurën e hapur, kur autoriteti shitës nuk ka vendosur asnjë kërkesë të veçantë për kualifikim, sipas procedurave të këtij vendimi dhe nuk është paraqitur asnjë ofertë për blerje, në vijim të procedurës së parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike, autoriteti shitës cakton një VAM tjetër 20% më të ulët se VAM-i i përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike. Në rast se edhe pas kësaj uljeje, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerje, VAM-i ulet deri 20% nga VAM-i i fundit, për çdo shpallje, derisa vlera të arrijë 30% të VAM-it fillestar të ankandit.

Përfshihet nga kjo procedurë shitja në ankand e pasurive të paluajtshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 359, datë 24.4.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 10 e nenit 6 “Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Akreditimit”, të rregullores “Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, miratuar me vendimin nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Mbledhja e Këshillit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 7 (shtatë) anëtarë të tij. Ajo nuk zhvillohet nëse, së paku, një ekspert i huaj nuk është i pranishëm.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Këshilli i Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 7, datë 8.3.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 29/1, DATË 16.08.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË KRYEN AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË”

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 60, nenit 61 dhe nenit 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14 të vendimit nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Në tabelën e pikës 1 të udhëzimit nr. 29/1 datë 16.8.2011 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë”, pikat “a” dhe “ç” revokohen.

2. Në pikën 1 të shkronjës “a” të tabelës në pikën 2 të udhëzimit, hiqet shprehja “ose kolegji”, dhe në tabelë shtohet një pikë 3 me përmbajtje si më poshtë:

3. Një kolegji profesional	376.000
----------------------------	---------

3. Shkronja “ç” e tabelës në pikën 2 të udhëzimit ndryshohet si më poshtë:

ç) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i Shkollës Doktorale dhe i një programi studimi të ciklit të tretë:		
1. Tarifa për akreditim ose vlerësim paraprak (shkenca sociale e humane)		552.000
2. Tarifa për akreditim ose vlerësim me ekspertë të huaj (fusha mjekësore dhe shkenca natyrore)		602.000
3. Tarifa për akreditim ose vlerësim të Shkollës Doktorale (njësi bazë), duke përfshirë të gjitha programet e ciklit të tretë që ofron kjo Shkollë Doktorale	Ekspertë vendas dhe të huaj	1.180.400

4. Pas shkronjës “ç”, shtohet një pikë “d” me përmbajtje si më poshtë:

d) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi profesional me kohëzgjatje 2 (dy) vjet: Tarifa për vlerësimin ose akreditimin e një programi të ciklit të shkurtër 2-vjeçar profesional	45.000
---	--------



5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr. 4, datë 15.4.2013

PËR DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A, B DHE C NË QENDRËN KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL)

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të dispozitave të gurmës “ç” të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, nenit 4 të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Deri në hartimin, miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” do të zbatohen këto procedura;

a) Leja e tipit C, e parashikuar në ligjin nr. 10448/2011, do të trajtohet si leje e nënkategorisë “Leje e thjeshtë mjedisore” me kodin III.1.A, e parashikuar në aneksin I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar, por do të quhet “Leja e tipit C”.

b) Leja e tipit B, e parashikuar në ligjin nr. 10448/2011, do të trajtohet si leje e nënkategorisë “Leje mjedisore” me kodin III.1.B, e parashikuar në aneksin I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538/2009, por do të quhet “Leja e tipit B”.

c) Leja e tipit A, e parashikuar në ligjin nr. 10448/2011, do të trajtohet si leje e nënkategorisë “Leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C, e parashikuar në aneksin I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538/2009, por do të quhet “Leja e tipit A”.

d) Deklarata Mjedisore, e parashikuar në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe e procedurës së vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 4.1.2013, do të trajtohet në nënkategorinë “Leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C, e parashikuar në aneksin I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538/2009, por do të quhet “Deklarata mjedisore”. Trajtimi i deklaratës mjedisore do të kryhet në përputhje me ligjin e sipërcituar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Kërkesat për leje mjedisi të tipit A, B dhe C paraqiten në QKL në përputhje me kërkesat e përgjithshme, sipas përcaktimit të dispozitave të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

KREU II APLIKIMI PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT “A”, “B” DHE “C”

1. Lejet e mjedisit shqyrtohen në përputhje me ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” mbasi bëhet aplikimi pranë Qendrës Kombëtare të Licencave.

2. Veprimtaritë që pajisen me leje mjedisi përcaktohen në shtojcën I të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

3. Deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave përkatës, subjektet që aplikojnë për leje mjedisi (të tipit A, B dhe C) në QKL duhet të paraqesin pranë QKL-së (dokumentacionin e pikës 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4) si vijon:

3.1. Relacion (projekti) për veprimtarinë që kërkon leje mjedisi ku në varësi nga natyra e veprimtarisë përfshihen të dhëna për:

a) qëllimin e veprimtarisë dhe datën e parashikuar të vënies në funksionim të instalimeve;
b) përshkrimi i vendndodhjes së veprimtarisë shoqëruar me hartë ilustruese dhe fotografi nga objekti;

c) përshkrimin e proceseve teknologjike të veprimtarisë;

d) llojin, volumin, konsumin dhe prodhimin e lëndëve të para sipas shtojcës I bashkëlidhur;

e) informacion i detajuar për shkarkimet në mjedis sipas shtojcës II bashkëlidhur;

f) informacion për cilësinë e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën e veprimtarisë ku do të kryhen shkarkimet në mjedis (të referohen të dhëna ekzistuese të prodhuara në kuadër të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit, në rast të mungesës së të dhënave të argumentohet nevoja dhe mundësia e kryerjeve të matjeve përkatëse);

g) pikat ku do të kryhen shkarkimet në ajër dhe ku do të shkarkohen ujërat e ndotura (vetëm pasi të kenë përmbyshur cilësinë e kërkuar për shkarkim, e cila përcaktohet në aktet ligjore përkatëse). Këto pika duhet të pasqyrohen në hartë të posaçme dhe të shoqërohen me koordinatat përkatëse;

h) rreziqet/aksidentet e mundshme në mjedis të veprimtarisë dhe nevojën për të parandaluar aksidentet ose kur këto ndodhin, për të minimizuar pasojat në mjedis;

i) masat për kapjen dhe trajtimin e ndotjes dhe shkarkimeve në mjedis sipas shtojcës III që synojnë;

- zbatimin e alternativave më të mira të disponueshme për parandalimin, ose kur nuk është e praktikueshme, për reduktimin e shkarkimeve nga instalimi/impianti;

- minimizimin/eliminimin e ndotjeve të konsideruara domethënëse;

- parandalimin e gjenerimit të mbetjeve, në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve, në rastet kur gjenerohen mbetje, mbetjet duhet të asgjësohen për të evituar ose për të reduktuar impaktin në mjedis;

- përdorimin efiçient të energjisë;

- marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe minimizimin e impakteve të tyre;

- marrjen e masave për të eliminuar rreziqet e ndotjes dhe krijimin e kushteve të favorshme në instalim/impiant, pas ndërprerjes së funksionimit të tij;

j) programin e vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis sipas shtojcës III;

k) planin e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;

l) planin e rehabilitimit për veprimtaritë që shfrytëzojnë burimet minerare (karrierat lumore dhe zhuret). Plani i rehabilitimit hartohet sipas kërkesave të vendimit nr. 3, datë 21.6.2006 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për rehabilitimin e shtretërve dhe të brigjeve të lumenjve, të dëmtuara nga shfrytëzimi i inerteve”, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 17.5.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”;



m) planin e përballimit të emergjencave dhe aksidenteve me pasojë në mjedis, për veprimtaritë që përdorin, prodhojnë dhe magazinojnë (depozitim) lëndë të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve apo substancat dhe preparatet e përshkruara në nenin 5 të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe sipas dispozitave të kreut VIII të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;

n) hartuesit e informacionit të pikës 3.1, certifikata e ekspertit të miratuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe nënshkrimet apo vulosjet respektive, ndërkohë për rastet e subjekteve juridike të paraqitet licenca e subjektit, ku eksperti është i punësuar, dhe nënshkrimet apo vulosjet respektive.

3.2 Informacioni për konsultimin me publikun të veprimtarisë ku publiku informohet për ndërveprimin e veprimtarisë me mjedisin dhe masat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe shpreh mendimin e tij, i cili dokumentohet dhe paraqitet në QKL. Informacioni paraqitet në QKL, si procesverbal që përmban, datën dhe vendin ku është zhvilluar konsultimi me publikun, personat e pranishëm dhe nënshkrimin përkatës, fotografi nga takimi dhe mendimet e dhëna nga të pranishmit gjatë takimit. Procesverbali nënshkruhet/vuloset nga subjekti që aplikon për leje mjedisi.

3.3 Kopjen e mandatit të pagesës së tarifës së shërbimit për shqyrtimin e kërkesës/aplikimit për leje mjedisi të tipit A, B dhe C sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 5, datë 25.12.2007 “Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore”. Në varësi nga projekti, tarifa paguhet vetëm njëherë dhe shërben për të dyja procedurat.

3.4 Lejet dhe autorizimet që disponohen paraprakisht për projektin/veprimtarinë dhe informacion për ato që duhet të merren për ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Dokumentacioni i aplikimit dërgohet elektronikisht nga QKL-ja në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe vendimi i miratimit ose i refuzimit publikohet nga institucioni tjetër vendimmarrës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

5. Afati i shqyrtimit dhe i marrjes së vendimit përfundimtar për lejet e mjedisit të tipit A dhe B është 5 javë kalendarike ndërsa për lejet e mjedisit të tipit C është 2 javë kalendarike nga data e aplikimit pranë QKL-së.

KREU III TRANSFERIMI I LEJEVE TË MJEDISIT

1. Për transferimin e lejes së mjedisit subjektet i drejtohen paraprakisht për miratim Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave duke paraqitur dokumentacionin më poshtë:

- a) kërkesën për transferimin e lejes së mjedisit;
- b) kopje të noterizuar të marrëveshjes midis subjekteve ku të vërtetohet transferimi i veprimtarisë së pajisur me leje mjedisi;
- c) kopje të lejes së mjedisit që kërkohet të transferohet;
- d) kopje të ekstraktit të QKR-së të subjektit, të cilit do t'i transferohet leja e mjedisit;
- e) deklaratë nga subjekti që do t'i transferohet leja e mjedisit në të cilën pranohet marrja e përgjegjësisë dhe e detyrimeve të lejes së mjedisit.

2. Pas marrjes së miratimit të mësipërm, subjekti paraqitet pranë sporteleve të QKL-së për të regjistruar transferimin në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ku dorëzon një kopje të aktit të miratimit për transferimin, si dhe kopje të dokumentacionit të pikës 1.

**KREU IV
SHFUQIZIMET**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohen këto akte nënligjore:

a) Udhëzimi nr. 2, datë 21.5.2007 “Për miratimin e listës së veprimtarive me ndikim në mjedis, mënyrën e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së autorizimit dhe pëlqimit mjedisor nga agjencitë rajonale të mjedisit”.

b) Udhëzimi nr. 2, datë 29.6.2010 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”.

c) Udhëzimi nr. 3, datë 20.8.2010 “Për standardizimin e formatit të aktit të miratimit të lejeve dhe autorizimeve mjedisore”.

d) Udhëzimi nr. 2/1, datë 9.2.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 2, datë 29.6.2010 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu**



SHTOJCA I - Te dhena specifike per lëndët e para

Tabela 1. – Lendet e para

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A përdorni lëndë të para?			
A përdorni materiale ndihmëse?			
A përdorni përzierje materialesh ?			
A përdorni lëndë djegëse (dhe/ose energji)?			
A përdorni kimikate sintetike/ laboratorike?			
Lutem rendisni materialet sipas volumeve qe perdoren	1, 2, 3, etj.		

Tabela 2 - Përdorimi/sigurimi i energjisë

	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A përdoret energji?			
A prodhohet kjo energji në territorin e impiantit apo sigurohet nga burime te tjera?			
Konsumi i lendeve diegese per sigurimin e energjise nese prodhohet ne impiant/instalim?			
Informacion tjetër sqarues?			

Tabela 3 _Konsumi i energjise dhe ujit

KONSUMI I ENERGIJË	
Burimi	Konsumi ditor dhe total ne baze viti (kwh/g, t/g, dhe të ngjashme)
Energjia Elektrike	
KONSUMI I UJIT	
Burimi i furnizimit	Konsumi ditor dhe total ne baze futi (m3)
Rrjeti publik	
Pus personal	
Informacion tjetër sqarues?	

SHTOJCA II – Te dhena specifike per shkarkimet ne mjedis dhe trajtimin e tyre

1. Shkarkimet ne mjedis dhe mbetjet

1.1. Shkarkimet në ajër

Pyetje	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A ka shkarkime në ajër (nga oxhaqet)			
A ka shkarkime në ajër (nga burime të shpërndara)?			
A ka erëra të këqija nga shkarkimet?			

1.2. Shkarkime të ujërave të ndotura

Pyetje	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A ka shkarkime të ujërave të ndotura?			
A ka ujëra të ndotura me natyre toksike?			
A bëhen shkarkime në rrjetin e kanalizimeve?			
A bëhen shkarkime në sipërfaqet ujore?			
Jepni sasinë e ujërave të ndotura (m3/ditë)			

1.3 Zhurma & vibracionet

Pyetje	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A gjenerohen zhurma?			
A gjenerohen vibracione?			

1.4 Mbetjet e ngurta

Pyetje	PO	JO	Nqse PO përshkruaj (Tipin, sasinë & burimin)
A gjenerohen mbetje të ngurta?			
A gjenerohen mbetje të ngurta të rrezikshme?			
Të asgjësuarat në territorin e impjantit/instalimit?			

1.5. Burimet e shkarkimit ne ajer:

Emërtimi i Shkarkuesit:	
Përshkrimi:	
Koordinatat (UTM Sistemi Koordinues):	
Informacion për oxhakun	m



Diametri:	m
Lartësia nga toka (m):	
Data e vënies në punë:	

1.6 Fluksi dhe kohezgjatja e shkarkimeve (për çdo pikë/burim shkarkimi) ne ajër

Rrjedha (volumi i shkarkuar):			
Vlera mesatare/ditë	Nm3/d	Maks./ditë	m3/d
Vlera maksimale/orë	Nm3/orë	Rrjedha min.	m.s-1
Faktorë të tjerë			
Temperatura	oC(max)	oC(min)	oC(vlera mes.)
Burimet e djegies:			
Vlerat e volumit të dhëna si:	☐ i thatë	☐ i njomë	%O2

1.7 Karakteristikat e shkarkimit ne ajër

Numri Referues i pikës së shkarkimit: _____

Parametri	Përpara trajtimi				Përshkrim i shkurtër i trajtimit	Pas trajtimit (filtra etj)			
	mg/Nm3		kg/orë			mg/Nm3		kg/orë.	
	Mes.	Maks.	Mes.	Maks.		Mes.	Maks.	Mes.	Maks.

Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerje e punës):

Kohezgjatja e shkarkimit (mesatare)	min/orë	orë/ditë	ditë/vit

1.8 Clirimi i zhurmës në mjedis

	Sistemi Koordinativ UTM (3 Veri, 3 Lindje)	Niveli i zhurmës /dB(A)		
		L(A) _{eq}	L(A) ₁₀	L(A) ₉₀
Mjediset/Godinat e instalimit/impianitit				
Vendndodhja 1:				
Vendndodhja 2:				
Vendndodhja 3:				
Vendndodhjet e ndjeshme të zhurmës				
Vendndodhja 1:				
Vendndodhja 2:				
Vendndodhja 3:				

Shënim: Të gjitha vendndodhjet duhet të shënohen qartë në hartat bashkëngjitur kësaj kërkesë.

2. Shkarkimet e ujerave te ndotura

1. Pika e shkarkimit:

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit (numri referues duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit/impantit)	
Burimi i shkarkimit:	
Vendodhja :	
Koordinatat në Sistemin Shtetëror të Koordinatave:	
Emri/Emërtimi i marrësit (lumi, liqenit ...):	

2. Informacion i detajuar per shkarkimet e lengta

Sasia e shkarkuar			
Mesatare/ditë	m ³	Sasia maksimale/ditë	m ³
Sasia maksimale/orë	m ³		

Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

Periudhat e shkarkimit (mesatare)	min/orë	orë/ditë	ditë/vit
--	---------	----------	----------

3. Karakteristikat e shkarkimeve te ujerave te ndotura

Parametri	Përpara trajtimit				Nga vendi i lirimit/lëshimit pas shkarkimit			
	Mesatarja max. e vlerës/orë (mg/l)	Mesatarja max. e vlerës ditore (mg/l)	kg/ditë	kg/vit	Vlera mesatare maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatares maks. (mg/l)	kg/ditë	kg/vit

SHTOJCA III - KAPJA DHE TRAJTIMI I NDOTJES DHE SHKARKIMEVE NE MJEDIS DHE MBETJEVE

1. Trajtimi i ndotjes



Lloji i shkarkimit/ndotjes (ne ajër, toke, uje)	Pershkrimi i trajtimit

2. Menaxhimi i mbetjeve

Material mbetjesh	Numri nga Rregullorja për Kategoritë e Mbetjeve, duke përfshirë listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjësimi në instalim/implant (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi, riciklimi ose asgjësimi jashtë instalimit/implantit (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m ³ / muaj		

3. Programi i vetmonitorimit të shkarkimeve

Vendodhja e monitorimit/Koordinatat në Sistemin e Koordinimit UTM: _____

Parametri ¹	Rezultatet (mg/l ose mg/m ³)				Metoda e marrjes së mostrës	Qëllimi/arsyeja e vlerësimit analitik	Metoda analitike/teknika
	Data	Data	Data	Data			

¹ Renditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifik të instalimit/implantit..

Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

UDHËZIM Nr. 4, datë 22.4.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT DHE PROCEDURËN E DHËNIES NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9385 datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të nenit 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Sipërfaqe të fondit pyjor/kullor publik jepen në përdorim me kontratë qiraje nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik.

2. Sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor që jepen në përdorim sipas përcaktimit të pikës 1 janë:

- sipërfaqe me pyje;
- sipërfaqe me bimësi pyjore;
- sipërfaqe inproduktive;
- sipërfaqe kullosore/livadh; si dhe
- infrastruktura përkatëse.

3. DSHP-të vlerësojnë dhe propozojnë në ministri, sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor, si dhe infrastrukturën përkatëse që mund të jepen në përdorim. Në vlerësimin e fondit pyjor e kullosor, që propozohen të jepen në përdorim, DSHP-të mbajnë parasysh që:

a) sipërfaqet mund të jepen vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 19 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe në nenin 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar;

b) veprimtaritë që do të ushtrohen në këto sipërfaqe, të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në përputhje me planet e tyre të mbarështimit;

c) afati i dhënies në përdorim të jetë në përputhje me afatin e planit 10-vjeçar të mbarështimit. Kontrata, pavarësisht kohëzgjatjes së saj, rinovohet çdo vit nga DSHP-ja përkatëse pasi verifikohet zbatimi i kushteve kontraktuale;

d) projektet e veprimtaritë që do të ushtrohen duhet:

- të sjellin përmirësime të dukshme në mbarështimin e florës dhe faunës që ndodhen në këto sipërfaqe;

- të realizojnë investime që përmirësojnë tregues biologjikë dhe të infrastrukturës së zonës;

- të mos cenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike;

- të jenë në përputhje me investimet publike që janë planifikuar të bëhen në zonë në 10 vitet e ardhshme.

4. Për çdo sipërfaqe që propozohet të jepet në përdorim, DSHP-ja propozon edhe llojin e veprimtarisë që mund të ushtrohet në të dhe përgatit studimin, i cili përmban:

a) sipërfaqen e fondit pyjor ose kullosor e shprehur në (ha), me kufij të përcaktuar qartë në harta të shkallës 1:10000 ose 1:25000 (koordinatat gjeografike, metrike);

b) treguesit identifikues (kadastralë) të ngastrave ose nënngastrave;

c) karakteristikat silvikulturale të grumbullit pyjor;

d) treguesit tekniko-ekonomikë për kullotat dhe livadhet;

e) treguesit e vlerës për çdo njësi kadastrë të pyjeve dhe kullotave që parashikohet të jepen me qira;

f) vlerën dysheme të qirasë për ha/vit, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

g) sipërfaqja e propozuar për t’u dhënë në përdorim të mos jetë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve;

h) sipërfaqja e propozuar të mos jetë objekt tjetërsimi në një afat 10-vjeçar në rastet kur në to janë planifikuar investime publike;

i) sipërfaqja që propozohet të jepet në përdorim për mbarështim flore të mos jetë më e vogël se madhësia limit e një nënngastre pyjore/kullosore.

5. Kur sipërfaqe të fondit pyjor propozohen që të ushtrohen veprimtari pushimi, DSHP-të përgatisin studimet sipas kërkesave të pikës 4 të këtij udhëzimi dhe në muajin janar të fillimit të vitit kalendarik i paraqesin këto studime në ministri për të marrë miratim për vazhdimin e procedurave të konkurrimit për dhënie në përdorim me kontratë qiraje, për një periudhë sezonale jo më shumë se 3 deri 4 muaj.

6. Pas shqyrtimit të propozimeve të DSHP-ve, drejtoria përkatëse teknike në ministri, në qoftë se plotësohen kërkesat, përgatit urdhrin, të cilin e përcjell te ministri për miratim. Pas miratimit, njoftohet drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor për të vazhduar procedurat e konkurrimit publik.



7. Subjektet publike ose private që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në sipërfaqet e fondit pyjor ose kullësor, mund të paraqesin kërkesën në formën e propozimit të pakërkuar në çdo kohë. Kjo sipërfaqe do të përdoret vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 19 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe në nenin 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, të ndryshuar. Propozimi duhet të plotësojë kërkesat e këtij udhëzimi.

8. Për administrimin e kërkesave në këto raste, DSHP-ja kryen këto detyra:

- a) përgatit raportin teknik për sipërfaqen e kërkuar;
- b) dërgon në ministri për shqyrtim dhe miratim kërkesën së bashku me raportin teknik;
- c) pas miratimit nga ministri, DSHP-ja, edhe në këtë rast, vazhdon procedurat e mëtejshme të prokurimit publik.

9. Pas marrjes së miratimit, titullari i DSHP-së urdhëron ngritjen e komisionit të përgatitjes së dokumenteve të prokurimit, i miraton ato dhe i dërgon për njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik.

10. Konkurrimi publik për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor bëhet:

a) nëpërmjet shpalljes së njoftimit për konkurrim publik për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor;

b) njoftimi bëhet nëpërmjet Buletinit të Prokurimit Publik, i cili përmban të dhënat për sipërfaqen, vendin dhe adresën ku mund të tërheqin dokumentacionet e nevojshme dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit;

c) data e konkurrit të jetë jo më parë se 10 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

11. Subjektet që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e kompanisë;
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar dhe që trajton të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- i) adresën subjektit, si dhe tel. dhe faks.

12. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;

b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;

c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj MMPAU-së.

13. Pas shpalljes së njoftimit, titullari i DSHP-së urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit. Urdhri për ngritjen e këtij komisioni përmban, gjithashtu, dhe:

a) të dhënat e zonës: emërtimi, sipërfaqja, koordinatat, qëllimi i përdorimit, çmimi dysHEME, afati;

b) veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë sipërfaqe;

c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrit, të përcaktuara sipas pikës 14 të këtij udhëzimi;

d) vendin, datën dhe orën ku paraqiten dokumentet;

e) përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, i cili në çdo rast përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë, specialistë të drejtorisë;

f) dokumentacionin që do të paraqitet në konkurrim nga konkurrentët.

14. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) hap në prani të konkurrentëve zarfet me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohura të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, ai skualifikon subjektin konkurrues në prani të tij;

b) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

c) brenda 10 ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi;

d) në përfundim, rendit konkurruesit në bazë të pikëve të përfituara;

e) paraqet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike, te drejtori, një informacion për zhvillimin e konkurrit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrit dhe listën e konkurruesve të renditur sipas pikëve të fituara.

15. Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshtë:

a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet që përmban planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000 ose 1:25000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;

b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen..... 15 pikë;

c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes..... 25 pikë;

d) nivelin e punësimit në veprimtari..... 5 pikë;

e) masën e qirasë për ha/vit..... 35 pikë.

16. Komisioni vendos për subjektin fitues të konkurrit. Njofton për shpalljen e fituesit në këndin e njoftimeve të DSHP-së.

17. Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te titullari, i cili, brenda 10 ditëve, i përgjigjet ankuesit me shkrim.

18. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, me fituesin lidhet brenda 10 ditëve kontrata e qirasë tip e miratuar nga ministri. Nëse fituesi nuk e lidh kontratën brenda këtij afati, kontrata lidhet me subjektin që është renditur i dyti në listën e konkurrit.

19. Sipërfaqja dorëzohet me procesverbal dhe në përfundim të përdorimit merret në dorëzim nga DSHP-ja po me procesverbal.

20. Kontrata e qirasë, veç të tjerash, përmban detyrimin e qiramarrësit:

a) për të zbatuar projektin, planin e investimeve dhe të rehabilitimit të sipërfaqes së përdorur;

b) për të ruajtur mjedisin rrethues nga ndotjet dhe dëmtimet që mund të shkaktojnë veprimtaria e tij;

c) për të siguruar mbrojtjen nga zjarri dhe angazhimin në shuarjen e tij;

d) për të informuar me shkrim në MMPAU ose DSHP për ecurinë e veprimtarisë e problemet që dalin.

21. PAGESA e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse.

22. Të ardhurat e siguruara nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore e kullosore, administrohen sipas shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit nr. 432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

23. Përfshihen nga konkurrimi, pavarësisht madhësisë së sipërfaqes, dhënia me qira e sipërfaqeve dhe e infrastrukturës ndihmëse kur subjektet juridike janë të pajisura me leje përkatëse për veprimtari të mëposhtme: që janë pajisur me lejet, licencat dhe dokumentet e nevojshme në plotësim të kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse (sipas ligjit nr. 10 304, datë



15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9396, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre, ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

a) për shfrytëzim të pasurive natyrore minerare (sipas ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij);

b) për peshkim dhe akuakulturë (ligji i peshkimit);

c) për përdorimin e ujërave;

d) për ndërtim të veprave hidroteknike (për shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh për HEC-e (sipas kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9396, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar + koncesionet);

e) për ndërtimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare (ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”);

f) për ndërtim të linjave elektrike e kabllove optikë, instalimeve të naftës apo gazsjellës;

g) për vendosje kullash të ndryshme vrojtimi/sinjalizimi (ligji i planifikimit të territorit);

h) ndërtim të kullave për parqe eolike dhe infrastrukturën ndihmëse (sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”);

i) dhënia me qira e sipërfaqeve dhe infrastrukturës ndihmëse në rastet kur me ligj, me vendimin e Këshillit të Ministrave, me vendim të KKT-së ose me marrëveshje koncesionare, subjektit të licencuar i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë;

j) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 0.1 ha, të cilat jepen me afat deri në 1 (një) vit pa të drejtë rinovim kontrate;

k) sipërfaqe të fondit pyjor që do të përdoren për rehabilitim (pyllëzim dhe ripyllëzim).

24. Për të lidhur kontratën e qirasë në rastet sipas pikës 23 të këtij udhëzimi, subjekti paraqet pranë DSHP-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për marrjen me qira të sipërfaqes;

b) projektin teknik, të shoqëruar me planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000 ose 1:25000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet eventuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të studimit apo projektit, kopje origjinale të miratuara;

c) vendimin e institucionit që ka miratuar projektin e zbatimit (ministër, këshilli mbikëqyrës, këshilli drejtues, bordi drejtues etj.);

d) planbизнесin dhe investimet për zhvillimin e aktivitetit;

e) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;

f) lejet, licencat apo autorizimet për ushtrimin e aktivitetit;

g) lejen mjedisore, pëlqimin apo autorizimin mjedisor, nëse veprimtaria që do të ushtrojë ka ndikime negative në mjedis.

25. Për të lidhur kontratën sipas kërkesës në pikës 3 të këtij udhëzimi, subjekti paraqet në DSHP; kërkesën; projektin teknik, të shoqëruar me planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000 ose 1:25000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet eventuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të studimit apo projektit, kopje origjinale të miratuara; lejet, licencat apo autorizimet për ushtrimin e aktivitetit.

26. Për kërkesat, sipas pikës 23 të këtij udhëzimi, DSHP-ja e shqyrton dosjen brenda 15 ditëve dhe, kur e gjen të rregullt, harton raportin teknik dhe e paraqet dosjen për miratim te ministri. Pas miratimit të ministrit, DSHP-ja dhe kërkuesi nënshkruajnë procesverbalin e dhënies së sipërfaqes dhe kontratën e qirasë tip të miratuar nga ministri.

27. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 1, datë 2.7.2012 “Për kriteret e konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”, shfuqizohet.

28. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë dhe sektorët përkatës në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe DSHP-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

VENDIM
Nr. 26, datë 27.3.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË
SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe neni 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 58 shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59 pikat 2 dhe 3 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 5.5.1999, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pas pikës 8.3.4 shtohen pikat 8.4 dhe 8.5 me përmbajtje si më poshtë:

“8.4. Pavarësisht përcaktimeve në pikat 8.1 deri në 8.3, banka rregullon totalin e aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun, siç përcaktohet më poshtë:

8.4.1. Duke shtuar vlerën e rritjes që rezulton në krahasim me muajin mars 2013, të klasave në aktiv të bilancit “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprime me letrat me vlerë”, me jorezidentët në valutë (sipas formularit 7, bashkëlidhur rregullores), pasi të jetë zbritur vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë që i përkasin të njëjtave klasa në atë periudhë raportuese;

8.4.2. Për vitin 2013, duke pakësuar me vlerën që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

a) vlerën e rritjes së tepricës bruto të huas për klientët², të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2012, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) për qind dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) për qind;

b) vlerën 10 (dhjetë) për qind të tepricës bruto të huas për klientët të akorduar brenda vendit, në muajin dhjetor 2012, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) për qind.

8.4.3. për vitin 2014, duke pakësuar, me shumën e vlerës që rezulton nga llogaritjet sipas pikës 8.4.2 dhe vlerës që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

a) vlerën e rritjes së tepricës bruto të huas për klientët të akorduar brenda vendit, në

² Sipas sistemit raportues të unifikuar, përfshihen: “individët”, “njësitë tregtare dhe industriale private”, “njësitë tregtare dhe industriale publike”, “punonjësit e bankës” dhe “klientë të tjerë”.



periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2013, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) për qind dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) për qind;

b) vlerën 10 (dhjetë) për qind të tepricës bruto të huas për klientët të akorduar brenda vendit, në muajin dhjetor 2013, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) për qind.

8.4.4 Përlllogaritjet sipas përcaktimeve të pikave 8.4.2 dhe 8.4.3 bëhen sipas formularit 8 bashkëlidhur rregullores.”

8.5 Nëse Banka e Shqipërisë nuk vendos ndryshe, pika 8.4 shfuqizohet në datën 31 dhjetor 2014. Me shfuqizimin e pikës 8.4, nëse banka nuk respekton nivelin minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje ose përcaktimeve të tjera të Bankës së Shqipërisë, banka merr masa për të respektuar këto kërkesa deri në datën 30 qershor 2015.

b) formulari 4, i përcaktuar në pikën 7.4 të rregullores, ndryshon sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 4

SHUMA E ZËRAVE TË AKTIVIT, SHUMA E ZËRAVE JASHTË BILANCIT TË PONDERUAR ME RREZIKUN PËRKATËS DHE SHUMA E ZËRAVE TË TJERË JASHTË BILANCIT
(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	LLOJI I FORMULARIT	EMËRTIMI	SHUMAT
1	Formulari 1	Totali i zërave të aktivit të ponderuara me rrezikun	
2	Formulari 2	Totali i zërave jashtë bilancit që përfaqësojnë kontratat e instrumenteve financiare mbi normat e interesit dhe kurset e këmbimit të ponderuara me rrezikun	
3	Formulari 3	Totali i zërave të tjerë jashtë bilancit	
4	Formulari 7	Shtesat për rritjen në klasat në “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprimet me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë	
5	Formulari 8	Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2013	
6	Formulari 8	Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2014	
		SHUMA (1 + 2 + 3 + 4 – 5 – 6)	

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 7

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, duke i bazuar klasat në “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprimet me letrat me vlerë” jorezidente në valutë
(në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, duke i bazuar klasat në “veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe “veprimet me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	Mënyra e llogaritjes
1.	Totali i zërave të aktivitetit “veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve, në valutë, mars 2013	(a)
2.	Totali i zërave të aktivitetit “veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë”, jorezidente në valutë në periudhën raportuese	(b)
3.	Rritja e zërave të aktivitetit “veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve, në valutë	(c) = (b) - (a)
4.	Totali i zërave të pasivitetit “veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë” të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(d)
5.	Totali i zërave të pasivitetit “veprimeve me thesarin dhe transaksioneve ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve, në valutë në periudhën raportuese	(e)
6.	Rritja e zërave të pasivitetit “veprimeve me thesarin dhe transaksionet ndërbankare” dhe i “veprimeve me letrat me vlerë”, të jorezidentëve në valutë	(f) = (e) - (d)
7.	Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(g) = 0 nëse (c) ≤ 0; (g) = (c) nëse (f) < 0 (g) = (c) - (f) nëse (f) > 0



FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 8

Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit (në mijë lekë)

Emri i bankës

Periudha raportuese

Data e raportimit

Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit	Mënyra e llogaritjes
1.	Portofoli i kredisë bruto, dhjetor 2012	(a)
2.	Portofoli i kredisë bruto në periudhën raportuese, 2013	(b)
3.	Rritja e portofolit të kredisë 2013	(c) = (b) - (a)
4.	Rritja e portofolit të kredisë për 2013-ën, me bazë vjetore sipas periudhës raportuese: nëse periudha raportuese është qershor, 2013 nëse periudha raportuese është shtator, 2013 nëse periudha raportuese është dhjetor, 2013	(d) = (c) * 2 ; (d) = (c) * 4/3 ; (d) = (c)
5.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2012	(e) = (a) * 4%
6.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2012	(f) = (a) * 10%
7.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për periudhën raportuese, 2013	(g) = 0 nëse (d) < (e) ; (g) = (d) nëse (e) < (d) < (f) ; (g) = (f) nëse (d) > (f)
8.	Portofoli i kredisë bruto në dhjetor, 2013	(h)
9.	Portofoli i kredisë bruto në periudhën raportuese 2014	(i)
10.	Rritja e portofolit të kredisë 2014	(j) = (i) - (h)
11.	Rritja e portofolit të kredisë për 2014-ën me bazë vjetore sipas periudhës raportuese: nëse periudha raportuese është mars, 2014 nëse periudha raportuese është qershor, 2014 nëse periudha raportuese është shtator, 2014 nëse periudha raportuese është dhjetor, 2014	(k) = (j) * 4 ; (k) = (j) * 2 ; (k) = (j) * 4/3 ; (k) = (j)
12.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2013	(l) = (h) * 4%
13.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2013	(m) = (h) * 10%
14.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik vetëm për periudhën raportuese 2014	(n) = 0 nëse (k) < (l) ; (n) = (k) nëse (l) < (n) < (m); (n) = (m) nëse (k) > (m)
15.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik në total për periudhën raportuese 2013 dhe 2014	(o) = (g) + (n)

VENDIM
Nr. 27, datë 27.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

I. Neni 13 i rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë” miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, e ndryshuar, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 13
Ristrukturimi i kredisë

1. Bankat, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojnë kredinë, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet e saj drejtuese. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet dhe kur, mbështetur në analizat e tyre, bankat gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.

2. Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit, deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt këstet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e ristrukturimit;

kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tri) këste (kryegjë dhe interes).

b) Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “të humbura”, “të dyshimta” ose “nën standarde”, nuk mund të klasifikohet, në asnjë rast, më lart se kategoria “nën standarde” deri në plotësimin e kushteve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni.

3. Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse ristrukturohet për herë të parë, ruan të njëjtën klasë dhe për të krijohen fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, me një normë jo më të vogël se 10 (dhjetë) për qind për kryegjë dhe interesin, deri në plotësimin e kushteve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni

4. Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse ristrukturohet për herë të parë, ruan të njëjtën klasë dhe për të krijohen fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë, me një normë jo më të vogël se 10 (dhjetë) për qind për kryegjë dhe interesin, deri në plotësimin e kushteve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni.

5. Kredia e ristrukturuar, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.”

II. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.



III. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr. 28, datë 27.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 3, nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 26 pika 1 shkronja “a”; të nenit 57 pikat 2, 3, 4 dhe 5; të nenit 58 pika 1 dhe nenit 66 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, miratuar me vendimin nr. 71, datë 14.10.2009, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si vijon:

Shkronja “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 19, ndryshojnë me përmbajtje si më poshtë:

a) “në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj, në nivelin minimal 15% (pesëmbëdhjetë për qind); dhe”

b) “në total në nivelin minimal 20% (njëzet për qind).”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 279, datë 12.3.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Astrit Danushi.

KËRKESË

Shtetasi Petrit Mena, i biri i Xhavitit dhe i Gjulsimes, i datëlindjes 29.7.1971, banues në Kamëz, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, njohjen e pavërtetësisë së dokumentit “Certifikatë vdekje” lidhur me përbërësit e gjendjes civile vetëm për datëlindjen dhe vendlindjen e shtetasit Hakik Mena, shpalljen e vdekjes dhe regjistrimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

KËRKUESI
Adem Tata

KËRKESË

Shtetasi Astrit Brahimi, i biri i Hajdarit dhe Zanës, lindur dhe banues në Vlorë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të zhdukur ose të vdekur të vëllait të tij shtetasit Dritan Brahimi, i datëlindjes 18.7.1971.

KËRKUESI
Astrit Brahimi

NREQJE GABIMI

Vendimi nr.198, datë 6.3.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, datë 10 prill, ka një gabim teknik në numër.

Ishte:

Vendim nr. 198, datë 6.3.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar

Bëhet:

Vendim nr. 189, datë 6.3.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 30.4.2013
Doli nga shtypi më 30.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 52 lekë